



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:181984

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05625206

Ac.nr.7240/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Besnik Bislimaj– kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit M. A. nga fshati B. Komuna e Podujevës të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av. B. A. nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "E." me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit V. A., për kompensimin e dëmit material dhe jo material, duke vendosur sipas ankesave të paditësit dhe të paditurës, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.601/2015 datë 20.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 22.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit M. A. nga fshati B. Komuna e Podujevës dhe refuzohet në tërësi si e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Elsig” me seli në Prishtinë dhe, NDRYSHOHET pika I pika a), II, III, V, VI e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.601/2015 datë 20.04.2021, sa i përket dëmit jo material dhe çështja tani gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Sigal” me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit jo material, si pasojë e aksidentit të shkaktuar me datën 03.09.2015, paditësit M. A. nga fshati B., Komuna e Podujevës, t’ia kompensoj shumat si në vijim: për dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 4,500.00 euro, për frikë të përjetuar shumë prej 4,000.00 €uro; për dhimbjet shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 5% shumë prej 3.000,00 €uro, për shëmtim truporë në shkallë të mesëm, shumë prej 3,000.00 euro. Pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditësit, përtej shumave të gjykuara e deri në shumat e kërkuara për këto kategori të dëmit, refuzohen si të pa bazuar.

II. PJESËRISHT refuzohet ankesa e paditësit M. A. nga fshati B. Komuna e Podujevës, ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.601/2015 datë 20.04.2021, në pikën I nënpika b), pika IV, kamatën e gjykuar, si dhe pjesa për shpenzimet për terapi fizikale, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.601/2015 datë 20.04.2021, ka vendosur: I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit M. A. nga fshati B. K. Podujevës SI E BAZUAR ashtu që OBLIGOHET e paditura KS "Elsig" me seli në Prishtinë, që paditësit në emër kompensimit të dëmit jo material dhe material të pësuar në aksidentin e datës 03.09.2015 që t'ia paguaj shumat si vijon:

a) Dëmi jomaterial

Në emër të dhimbjeve fizike ju aprovua shuma prej 2.500.00 euro. 4000 4500 Në emër të frikës shuma prej 2.000.00 euro. Në emër të ZAPJ në shkallë prej 5% shuma 2.000.00 euro. 3000 4000 Në emër të shëmtimit trupor shkalla e mesme shuma prej 1.500.00 euro. 3000. Gjithsejtë paditësit për dëmin jomaterial ju aprovua shuma prej 8.000.00 euro.

Përtej shumës së aprovuar shuma tjetër e kërkuar prej 22.150.00 euro ju refuzua si e pa bazuar.

b) Demi material:

Në emër të ndihmës së huaj ju aprovua shuma prej 300.00 euro.

-Në emër të ushqimit të përforcuar shuma prej 350.00 euro.

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e paditësit për terapi fizikale dhe rehabilitim për shumën e kërkuar prej 240.00 euro. Gjithsejtë paditësit për dëmin material ju aprovua shuma prej 650.00 euro.

Përtej shumës së aprovuar shuma tjetër prej 1.020.00 euro ju refuzua si e pa bazuar.

II. Gjithsejtë paditësit për dëmin jomaterial dhe material ju aprovua shuma prej 8.650.00 euro.

III. Përtej shumës së aprovuar për dëmin jomaterial dhe material shuma tjetër prej 23.170.00 euro ju refuzua si e pa bazuar.

IV. DETYROHET e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 864.00 euro.

V. Shumat e aprovuara për paditësin për dëmin jomaterial dhe material prej 8.650.00 e paditura obligohet t'ia paguaj paditësit me kamatën ligjore prej 8%, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive.

VI. Krejt këto shuma të aprovuara prej 8.650.00 si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore prej 864.00 euro, e paditura detyrohet t'ia paguaj paditësit në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

VII. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës paditëse që kamata në shumën e aprovuar ti llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë dt.15.12.2015 e deri në pagesën definitive sipas dispozitave të LMD-së.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjor, e paditura, ka parashtruar ankesë, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që të aprovoj ankesën e të paditurës si të bazuar dhe ta anuloj aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështja të kthehet në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjithashtu, kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjorë, paditësi ka paraqitur ankesë për shkak të: konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që të aprovohet ankesa e paditësit si e bazuar , ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe ta aprovoj kërkesë padinë e paditësit në tërësi si të bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.

-ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal” është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi M. A. nga fshati B., Komuna e Podujevës, me datë 15.12.2015, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Sigal” me seli në Prishtinë, për kompensim të dëmit material dhe jo material, të cilën kërkesë paditësit e ka precizuar me parashtrësën e dorëzuar me shkrim, konkretisht si në të njëjtën parashtrësë.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka mbajtur shqyrtimin kryesore, pas deklaramit të palëve ndërgjyqëse, administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr. 601/2015 datë 20.04.2021, me të cilin ka vendosur që të aprovohet pjesërisht kërkesëpadija e paditësit, duke vendosur me saktësisht si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se: Meqenëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadiisë atëherë Gjykata me zbatim të nenit 321.2 të LPK-së ku thuhet se: “Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor”. Gjykata për të aprovuar lartësinë e shumave të kërkuara në kërkesëpadi të precizuar nga pala paditëse nxori provën mjekësore me ekspertët e lëmisë së Ortopedisë dhe Traumatologjisë Dr. M. H. Ortoped, klinikes së kirurgjisë plastike Dr. E.. H. kirurg plastik dhe klinikes së psikiatrisë Dr. S. B. - Gashi psikiatër që të tre pranë QKUK Prishtinë, të cilët u deklaruan me ekspertizën me shkrim të paraqitur për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse me dt.21.01.2021. Ekspertët u deklaruan lidhur me lëndimet e marra të paditësit në

aksidentin e komunikacionit të dt.03.09.2015, natyra dhe lloji i lëndimeve, pasojat eventuale përhëndetin e tij si dhe frikën e përjetuar.

Më tej ka arsyetuar se: Ekspertët në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit kanë konstatuar në mendimin e tyre Professional se paditësi ka pësuar këto lëndime: Plagë prerese-shqyese në pjesën e kërcirit të majtë; gërvishtje të shumta në pjesën e ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme – të shkaktuara nga goditja e mjetit të fortë, si pasojë e aksidentit në trafik dhe si të tilla i kanë cilësuar si lëndim i rëndë trupor. Me këto prova të administruara gjykata në emër të dhimbjeve fizike e aprovoj kërkesën e paditësit në shumën prej 2.500.00 euro, derisa ai në precizim kërkoj shumën prej 9.500.00 euro, me ç' rast shuma prej 7.000.00 euro ju refuzua si e pa bazuar dhe e lartë. Këtë shumë të aprovuar nga gjykata e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped dhe atij kirurg plastik paditësi si pasojë e lëndimeve të marra në aksident ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 30 minutash, koha e kaluar nga aksidenti, nxjerrja nga automjeti i aksidentuar, deri te transporti, shtrirja e ekstremitetit të lënduar, procedurat diagnostifikuese dhe invazive, si vendosja e kanilave, katetrit etj., deri në mjekim dhe marrjen e terapisë kundër dhimbjes. Dhimbje fizike të intensitetit të rëndë të intensitetit të rëndë që kanë zgjatur për 3, që manifestohen si pasojë e plagëve të mëdha sidomos në gjurin e djathtë të cilat përcillen me dhimbje përkundër marrjes së terapisë kundër dhimbjeve pasi nuk mund të imobilizohen dhe japin dhimbje në çdo lëvizje. Të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur për 30 ditë kohë e nevojshme për konsolidimin e indeve të buta si dhe ligamenteve si dhe dhimbje të intensitetit të ultë që ka edhe sot e kësaj dite sidomos gjatë sforcimeve dhe ndryshimeve të motit. Në emër të frikës së pësuar gjykata e ka caktuar shpërblimin në shumë prej 2.000.00 euro edhe pse i kërkoj 6.650.00 euro, mirëpo gjykata ja refuzoj shumën prej 4.650.00 euro si e lartë. Shumën e aprovuar gjykata e vlerësoi si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se, sipas mendimit të ekspertes së psikiatrisë paditësi ka pësuar frikë primare, Pastaj ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit të lartë. Kjo frikë gradualisht është zbehur dhe ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit të mesëm dhe kjo ka kaluar pastaj në frikë sekondare të intensitetit më të ulët.

Më tej ka arsyetuar se: Në emër të ZAPJ në shkallë prej 5% gjykata ja aprovoj shumën prej 2.000.00 euro kurse shumën tjetër të kërkuar prej 6.000.00 euro ia refuzoj si të pa bazuar, e lartë dhe jo në harmoni me lëndimet e përjetuara, shkallën e zvogëlimit, praktikën gjyqësore dhe pjesërisht kriteret e KS-ve. Gjukata është e mendimit se shuma e aprovuar për paditësin për këtë kriter është adekuate me zvogëlimin e përjetuar të tij. Ky zvogëlim ka të bëjë me kufizimin e lëvizjes së nyjës së gjurit të djathtë në shkallë të lehtë e krahasuar me këmben e shëndoshë. Në emër të shëmtimit trupor në shkallë të mesme gjykata ia aprovoj shumën prej 1.500.00 euro, ndërsa shumën tjetër të kërkuar prej 4.500.00 euro ia refuzoj si të pa bazuar sepse shëmtimi ishte i shkallës së mesme si pasojë e vragës në formë kelloidi si pasojë e plagës prerese - shqyese në formë të çrregullt në pjesën anësore të gjurit të djathtë dhe kërcirit me madhësi prej 15 cm e gjerësi prej 3.5 dhe 7 cm. Pastaj vragën në pjesën e përparme të shputës dhe nyjës së zogut të këmbës së djathtë më gjatë 7 dhe 3 cm. e gjerësi prej 0.5 cm., të dukshme në kohë pas kohe sidomos gjatë muajt të ngrohtë të vitit kur paditësi ekspozohet me veshje të shkurtra. Kjo shumë ju aprovua edhe për faktin se paditësi është i moshës së re dhe kjo ndikon emocionalisht tek ai,

mirëpo vrugat nuk i ka çdo herë në ekspozim ndaj personave tjerë vetëm gjatë muajve të verës dhe kur bën veshje të shkurtra.

Më tej ka arsyetuar se: Në emër të ndihmës së huaj për 30 ditë gjykata ia aprovoj shumën prej 300.00 euro, kurse i refuzoj shumën tjetër të kërkuar prej 360.00 euro si të pa bazuar dhe si të lartë, në emër të ushqimit të përforcuar për 35 ditë gjykata ia aprovoj shumën prej 350.00 euro, kurse shumën tjetër të kërkuar nga 770.00 euro ia refuzoj shumën prej 320.00 euro, sepse gjykata e vlerësoj si shumë të drejtë dhe në harmoni me pasojat që ka lënë aksidenti te paditësi, me ato që ishin vlerësuar nga eksperti mjekësor dhe të parapara me kriteret e KS–ve.

Më tej ka arsyetuar se: Gjykata i aprovoj këto kërkesa edhe pse pala paditëse nuk ofroj prova materiale - fatura se sa ka shpenzuar për ushqim të përforcuar, çfarë ushqimi ka përdorur, kush i ka dhënë ndihmën atij dhe çfarë ndihme ka marrë ajo, por duke marrë parasysh moshën e tij te re gjykata e vlerësoi se ajo vërtet ka pasur nevojë për ndihmën e huaj dhe për ushqim të përforcuar se ato janë të parapara me kriteret e vet Kompanive të Sigurimit si të tilla dhe vetë ekspertet mjekësorë. Po ashtu sipas praktikës gjyqësore palët e kanë të pa mundur të sigurojnë prova - dëshmi konkrete për këtë lloj dëmi material, pasi që dihet se kryesisht për të lënduarit kujdesen familjarët e tij, kurse ushqimi i përforcuar është e vështirë të argumentohet.

Më tej ka theksuar se: Të pa pranuar janë kundërshtimet e paditurës që propozon gjykatës t'ia refuzoj palës paditëse kërkesat për dëm material për ndihmën e huaj dhe ushqim të përforcuar, sepse këto lloje dëmi i kanë paraparë Kompanitë e Sigurimeve dhe në vetë kriteret e tyre dhe janë të pa qëndrueshme kundërshtimet e saj. Mirëpo me të drejtë i pala paditur e kundërshtoj kërkesën e palës paditëse për terapi fizikale dhe rehabilitim në shumën e kërkuar prej 240.00 euro, sepse vërtetë pala paditëse nuk e ofroj asnjë provë materiale – faturë se a ka qenë në ndonjërin prej banjave dhe qendrave rehabilituese dhe fiziatrike sa ka shpenzuar, por nuk e bëri këtë edhe pse për këtë e obligon dispozita e nenit 7.1 lidhur me nenin 319.1 të LPK–së. Prandaj gjykata ia refuzoj këtë kërkesë si të pa bazuar për shumën e kërkuar.

Më tej ka arsyetuar se: Pas deklarimit të eksperteve, deklarimit të autorizuarit të paditëses se mbetet pranë kërkesave të cekura në petitum të padisë dhe precizim të kërkesëpadisë dhe deklarimit të palëve, gjykata duke pasur parasysh dispozitat e LMD-së së vitit 2013 ligji nr.04/L-077 praktikën gjyqësore kriteret e KS-ve, natyrën dhe llojin e lëndimeve, frikën e përjetuar moshën e tij të re të paditësit vendosi t'ia aprovoj shumat siç janë cekur në pikën I, II dhe IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Aprovimi i pjesshëm i kërkesëpadisë dhe shumat e gjykuara nga gjykata janë shpërblim real, objektiv dhe është bindja e plotë e gjykatës se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe qëllimin shoqëror që i shërben ky kompensim, natyrën e lëndimeve, lloji i lëndimeve, pasojat e mbetura dhe frikën e përjetuar. Shumat e aprovuara për paditësin janë satisfakcioni më real i mundshëm për rastin konkret. Gjykata gjatë aprovimit të këtyre shumave pati parasysh parimin që mos të pasurohet pa bazë njëra palë e të dëmtohet pala tjetër. Pjesa refuzuese e shumave të kërkuara nga gjykata kanë të bëjnë me atë se ato ishin shumë të larta, kundërshtim me kriteret e KS-ve, praktiken gjyqësore, natyrën e lëndimeve intensiteti i dhimbjeve dhe LMD-së së vitit 2012. Andaj, Gjykata konsideron se shumat e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi paraqesin një satisfakcion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuar të paditësit në aksidentin e komunikacionit, lëndimin dhe pasojat, duke marrë

parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 183 të LMD-së, standardin jetësor të qytetareve të Kosovës dhe praktiken e Gjykatave të Kosovës.

Për mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 136, 137, 140, 159, 169, 183, 158, 183 të LMD-së.

Në lidhje me kamatën është vendosur në kuptim të nenit 382.2 të LMD-së.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës është vendosur në kuptim të nenit 449, 452 dhe 453 të LPK-se.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është pjesërisht i drejtë dhe i ligjshëm në pjesën e ndryshuar, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, mirëpo e drejta materiale pjesërisht është zbatuar në mënyrë të gabuar. Gjithashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë dhe i ekzaminueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike i dispozitivit me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa qëndrueshme pretendimet ankimore të paditësit dhe të paditurës për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga provat që gjinden në shkresat e lëndës, të cilave dhe ja bali besimin e plotë edhe gjykatë së Apelit i rezulton e njëjta gjendje faktike e vërtetuar si ajo e gjykatës së shkallës së parë. pasi që pa mëdyshje është vërtetuar se ekziston përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 03.09.2015, i cili dëm është shkaktuar me fajin e të siguruarit të të paditurës, gjë që e paditura nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesë padisë së paditësit. Gjykata e shkallës së parë lartësinë e kërkesës e ka bazuar në mendimin e ekspertëve Dr. M. H. Ortoped, Dr. E. H. kirurg plastik dhe Dr. S. B. – G. psikiatër, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional në lidhje me natyrën e lëndimeve trupore, dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar, shëmtimit truporë si dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, e që gjykata e shkallës së parë në bazë të këtyre mendimeve ka përcaktuar edhe lartësinë e kompensimit të dëmit jo material të vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale nga gjykata e shkallës së parë në pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të ankimuar kur janë gjykuar shumat për demin jo material ne emër te dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar, shëmtimit truporë dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë. Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 183 të LMD-së. Pasi që për këtë kategori të dëmit shumat janë të tejet të ulta dhe nuk paraqesin kompensim realë për kompensimin e dëmit dhe as nuk janë në pajtueshmëri as me praktikën gjyqësore si dhe udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. 41/2023 të datës 27.02.2023, Pasi që shumat e gjykuara si në aktgjykimin e ankimuar janë të ulëta dhe nuk u shkojnë përshtati synimeve dhe qëllimeve shoqërore për kompensimin e dëmit dhe as nuk janë në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore, prandaj gjykata e shkallës së dytë e aprovoi pjesërisht ankesën e të paditësit, ndryshoi aktgjykimin e ankimuar pjesërisht për këto kategori të dëmit dhe gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se shumat e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e kompensimit të dëmit jo material nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim, e as në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Kosovës për këto forma të shpërblimit të demit dhe as në natyrën dhe llojin e së mirës së dëmtuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se shuma e gjykuar si në dispozitivin nën I të e aktgjykimit të shkallës së dytë janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 183 të LMD, këto shuma përfaqësojnë një satisfaksion adekuat që i dëmtuari t'i përballojë më lehtë demin jo materiale të pësuar edhe pse kjo formë të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me paragrafin 2 të nenit 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcaktohet se *“me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, dhimbjeve fizike, frikën e përjetuar, shëmtimin trupor, zvogëlimin të aktivitetit jetësor, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përbalimin e tejkalimit të pasojave të dëmit. Shuma e gjykuar nga gjykata e shkallës së dytë si në pikën I të dispozitiv të këtij aktgjykimi është reale dhe paraqet satisfaksion të vërtet dhe u shkojnë për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e demit. Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes mori parasysh të gjitha rrethanat siç janë: moshën e paditësit, intensitetin e frikës së përjetuar, shkallën e zvogëlimin të aktivitetit jetësor në lartësi prej 5%, shkallën e mesme të shëmtimit truporë, e konstatuar nga mendimi i ekspertëve të cekur më lartë si dhe praktikën gjyqësore të krijuar gjerë më tani e gjithashtu udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. 41/2023 të datës 27.02.2023 sa i përket shpërblimit të dëmit për këto kategori të dëmit.

Përveç kësaj Gjykata e Apelit e mbështet vendimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me kërkesëpadinë e paditësit sa i përket dëmit material për ushqim të përforcuar, dhe ndihmën e personit të tretë, pasi që ky lloj kompensimi i gjykuar sipas aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me rrethanat e tjera të krijuara si dhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se për paditësin ka qenë e nevojshme ushqimi i përforcuar për 35 ditë, ndihma e personit të tretë në kohëzgjatje prej 30ditë, dëme ky që është i mbështetur edhe në provat

materiale që gjinden në shkresat e lëndës si dhe nevojat e paditëses të përcaktuara nga ekspertët e cekur si më lartë.

Gjykata e Apelit nuk i mori për bazë pretendimet e paditësit në lidhje me kërkesën për dëmin material për shpenzimet e terapisë fizikale, pasi që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur kur ka refuzuar kërkesë padinë e paditësit për këtë kategori të dëmit, pasi që i njëjti nuk ka ofruar prova për të vërtetuar faktin se ky dëm është shkaktuar pasi që ky dëm duhet të argumentohet me prova material dhe se për gjykatën e Apelit nuk mjafton vetëm fakti i konstatimit të ekspertëve se paditësi ka nevojë për terapi fizikale, por është e domosdoshme të vërtetohet se paditësi ka realizuar terapinë fizikale dhe se i njëjti ka shpenzuar mjete monetare në shumën e kërkuar. Andaj në këtë kuptim, është përgjegjësi e paditësit të ofrojë prova në kuptim të nenit 7 të LPK-së, e që në rastin konkret i njëjti ka dështuar të ofrojë prova materiale për të vërtetuar kërkesë padinë e tij për këtë kategori të dëmit.

Sa i përket vendimit për kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që kamata e gjykuar është në pajtueshmëri të plotë me nenin 382 të LMD-së dhe se e njëjta do të filloj të rrjedhë nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale të gjykuara nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime në përputhshmëri të plotë me veprimet procedurale, e gjithashtu duke pas parasysh edhe suksesin e paditësit në procedurë dhe atë në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika c) dhe e), të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7240/2021, me datën 22.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj